

SHQIP sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015.
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakut të vetëm të Shoqërisë SHQIP sh.p.k

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë SHQIP sh.p.k, (më poshtë "Shoqëria") të citat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.


Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit


Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të SHQIP sh.p.k, më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

 MAZARS

Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Irena Hoxha (Pulo)

Irena Hoxha (Pulo)
Partner Angazhimi



30 prill 2016

SHQIP shpk

*(Vlerat janë në Lek)*Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	4,510,742	1,782,505
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	19,212,116	21,208,458
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	1,400,000	3,485,113
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	639,081	453,216
Inventarë	8	979,510	1,001,368
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	845,520	932,478
Total aktive afatshkurtra		27,586,969	28,863,138
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	4,162,070	6,662,936
Total aktive afatgjatë		4,162,070	6,662,936
Total aktive		31,749,039	35,526,074
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	114,600	117,011
Llogari të pagueshme tregtare	12	59,520,537	55,777,541
Detyrime tatimore	13	418,344	371,294
Të ardhura të shtyra	14	16,568	6,707
Total detyrime afatshkurtra		60,070,049	56,272,553
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	15	-	444,523
Total detyrime afatgjatë		-	444,523
Totali i detyrimeve		60,070,049	56,717,076
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	16	100,000	100,000
Rezerva ligjore		20,000	10,000
Fitime/Humbje të mbartura		(21,311,002)	(21,423,513)
Fitimi/Humbje të ushtrimit	26	(7,130,008)	122,511
Total i kapitalit		(28,321,010)	(21,191,002)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		31,749,039	35,526,074

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHQIP shpk

*(Vlerat janë në Lek)*Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	50,527,485	65,900,700
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	199,417	208
Lenda e pare, materiale dhe shpenzime		(41,015,158)	(48,131,934)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime	19	(18,177,273)	(26,299,289)
2) Të tjera shpenzime	20	(22,837,885)	(21,832,645)
Shpenzime të personelit	21	(19,281,807)	(15,787,372)
1) Paga dhe shpërblime		(16,601,626)	(13,625,078)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,680,181)	(2,162,294)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	22	(1,467,002)	(1,540,855)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(700)	(305)
Të ardhura të tjera	24	3,933,787	231,910
Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme		3,933,787	231,910
Shpenzime financiare	25	(26,030)	(66,912)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(29,705)	(66,143)
2) Shpenzime të tjera financiare		3,675	(769)
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		(7,130,008)	605,440
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(482,929)
Fitimi/humbja e vitit	26	(7,130,008)	122,511
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(7,130,008)	122,511

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHQIP shpk



(Vlerat janë në Lek)


Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Lijore	Fitime të Pashpërndara	Fitim/Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	100,000		(24,845,160)	3,431,647	(21,313,513)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				122,511	122,511
Tranferime në fitim/humbje të mbartura		10,000	3,421,647	(3,431,647)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	100,000	10,000	(21,423,513)	122,511	(21,191,002)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				(7,130,008)	(7,130,008)
Tranferime në fitim/humbje të mbartura		10,000	112,511	(122,511)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	100,000	20,000	(21,311,002)	(7,130,008)	(28,321,010)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i SHQIP sh.p.k më 29/03/2016 dhe janë firmosur si më poshtë.


 Besë Miftari
 Administrator



 ILD - 99 Audit
 Hartues i Pasqyrave Financiare

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(7,130,008)	122,511
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Diferenca konvertimi jo nga aktivitet operative	203,092	208
Fitim nga shitja e AAM-ve	1,047,864	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,467,002	1,540,855
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>	*	
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	3,781,275	(4,799,480)
Rënie/(rritje) në inventarë	21,858	763,614
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	3,799,907	11,774,972
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	(104,620)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	3,190,990	9,298,060
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(14,000)	(1,800,908)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(14,000)	(1,800,908)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(450,609)	(6,410,774)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(450,609)	(6,410,774)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,726,381	1,086,378
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	1,782,505	697,352
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	1,856	(1,225)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4,510,742	1,782,505

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria **Shqip** sh.p.k me Nipt K 61528011 E është krijuar me vendim Gjykate të rrethit Tiranë nr. 35118 datë 02.03.2006.

Aktiviteti kryesor i saj është: Botimi, prodhimi, dhe shpërndarja e gazetave, revistave, librave dhe materialeve të tjera të lejuara me ligj.

Kapitali themeltar është: 100.000 lekë.

Ortak i vetëm i shoqërisë është shoqëria "Digit – Alb" Sh.a.

Shoqëria "**Shqip**" sh.p.k është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave Tiranë.

Adresa e shoqërisë është në Rrugën 5 Dëshmorët, ndërtesa 5 katëshe, Nr 20, Kashar, Mézez, Tiranë.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 35.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuarat të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23

3.2 Instrumentat financiarë

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.9. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	847,416	1,038,717
Banka ALL	806,686	1,024,021
Banka EUR	40,730	14,696
Mjete monetare në arkë	3,663,326	743,788
Arka ALL	3,663,326	743,788
Arka EUR	-	-
Totali	<u>4,510,742</u>	<u>1,782,505</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë	19,212,116	21,208,458
Totali	<u>19,212,116</u>	<u>21,208,458</u>

SHQIP shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Digit-alb	1,400,000	3,485,113
Totali	<u>1,400,000</u>	<u>3,485,113</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor^f 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Tatim mbi fitimin	639,081	453,216
Totali	<u>639,081</u>	<u>453,216</u>

8. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mallra për rishitje	975,510	1,001,368
Totali	<u>975,510</u>	<u>1,001,368</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Parapagime për furnitorët	177,978	180,275
Shpenzime të shtyra	667,542	752,203
Totali	<u>845,520</u>	<u>932,478</u>

SHQIP shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilije dhe orendi	Kompjutera	Pajisje zyre	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 dhjetor 2013	3,642,202	8,149,248	642,233	7,278,234	2,770,788	22,482,705
Shtesa	271,700	1,529,208				1,800,908
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	3,913,902	9,678,456	642,233	7,278,234	2,770,788	24,283,613
Shtesa		14,000				14,000
Nxjerrje jashtë përdorimit	(991,040)	(4,976,602)	(602,700)		(2,595,788)	(9,166,130)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,922,862	4,715,854	39,533	7,278,234	175,000	15,131,483
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	2,658,966	6,937,652	518,629	3,861,442	2,103,133	16,079,822
Amortizimi i vitit	225,159	441,496	24,720	683,364	166,116	1,540,855
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	2,884,125	7,379,148	543,349	4,544,806	2,269,249	17,620,677
Amortizimi i vitit	205,955	594,276	19,776	546,687	100,308	1,467,002
Nxjerrje jashtë përdorimit	(820,725)	(4,557,674)	(529,896)		(2,209,971)	(8,118,266)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,269,355	3,415,750	33,229	5,091,493	159,586	10,969,413
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2013	983,236	1,211,596	123,604	3,416,792	667,655	6,402,883
Gjendja më 31 dhjetor 2014	1,029,777	2,299,308	98,884	2,733,428	501,539	6,662,936
Gjendja më 31 dhjetor 2015	653,507	1,300,104	6,304	2,186,741	15,414	4,162,070

SHQIP shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

11. Hua Afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Kredi Union Bank	114,600	117,011
Totali	<u>114,600</u>	<u>117,011</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë	59,520,537	55,777,541
Totali	<u>59,520,537</u>	<u>55,777,541</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Sigurime Shoqërore dhe shëndetsore	349,614	313,796
Tatim mbi të ardhurat personale për punonjës (TAP)	44,850	44,850
Tatim në burim	23,880	-
TVSh për t'u paguar	-	12,648
Totali	<u>418,344</u>	<u>371,294</u>

14. Të ardhura te shtyra

Në këtë zë përfshihen të ardhurat e shtyra të cilat lidhen me abonimet që i perkasin periudhës në vazhdim dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Te ardhura te shtyra	16,568	6,707
Totali	<u>16,568</u>	<u>6,707</u>

15. Hua Afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Kredi Union Bank – pjesa afatgjatë	-	444,523
Totali	<u>-</u>	<u>444,523</u>

SHQIP shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

16. Kapitali themeltar

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 100,000 lekë.

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Numri i kuaotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	1,000	1,000
Kapitali themeltar	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore e shoqërisë është në vlerën 20,000 lekë.

Fitime/Humbje e mbartur

Shuma prej (21,311,002) lekë përfaqëson humbjen e mbartur nga vitet e kaluara. (2014 : (21,423,513) lekë)

Humbja e vitit ushtrimor

Shuma prej (7,130,008) lekë përfaqëson humbjen e këtij viti ushtrimor. (Fitimi i vitit 2014 : 122,511 lekë)

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	14,582,483	16,575,980
Të ardhura nga reklamat	30,156,554	41,908,912
Të ardhura të tjera	5,788,448	7,415,808
Totali	<u>50,527,485</u>	<u>65,900,700</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne	
Qarkullim i tatueshëm	50,537,346
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2014	6,707
Zbrihen të ardhurat e shtyra për 2015	(16,568)
Shuma e qarkullimit të korrektuar	50,527,485
Diferenca nga Fitim/Humbjet Valutore-Tregtare	199,417
Sipas Kontabilitetit	50,726,902
Diferenca	<u>-</u>

SHQIP shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore	(14,566)	(22,107)
Fitim nga këmbimet valutore	213,983	22,315
Totali	199,417	208

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave të shitura e cila detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Kostoja e mallrave të shitur	16,043,067	19,297,850
Sherbim fotografie dhe dizenjimi	2,134,206	7,001,439
Totali	18,177,273	26,299,289

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Publicitet , rekama	8,570,000	5,572,400
Komisione dhe honorare	3,273,125	3,204,603
Shpenzime qeraje	2,605,675	2,281,272
Blerje të ndryshme, kancelari etj	2,230,575	2,266,630
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,484,052	2,251,488
Komisione dhe transporti	909,977	754,852
Karburant	812,650	2,163,140
Sigurime	908,469	1,030,845
Abonime	318,749	495,776
Shpenzime të tjera	547,977	1,665,678
Vl mbetur nga D/J perdorimi AAM	1,047,864	-
Komisione bankare	98,885	97,291
Taksa të ndryshme	29,887	48,670
Totali	22,837,885	21,832,645

SHQIP shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime për paga	16,601,626	13,625,078
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,680,181	2,162,294
Totali	<u>19,281,807</u>	<u>15,787,372</u>

22. Shpenzime amortizimi

Shpenzimi i amortizimit të aseteve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime amortizimi	1,467,002	1,540,855
Totali	<u>1,467,002</u>	<u>1,540,855</u>

23. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor ;

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Penalitete dhe gjoka	700	305
Totali	<u>700</u>	<u>305</u>

24. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura të tjera	3,933,787	231,910
Totali	<u>3,933,787</u>	<u>231,910</u>

SHQIP shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura/(shpenzime) nga këmbimet valutore nga huaja	3,675	(769)
Shpenzime për interesa	(29,705)	(66,143)
Totali	(26,030)	(66,912)

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
<i>Fitimi para tatimit</i>	(7,130,008)	605,440
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	2,775,738	2,614,086
Shpenzime të tjera	2,775,738	2,614,086
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	(4,354,270)	3,219,526
Humbja fiskale e mbartur	-	-
<i>Tatim fitimi 15%</i>	-	(482,929)
Fitim/(Humbja) neto	(7,130,008)	122,511

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Digitalb	1,400,000	-	3,485,113	4,180,267
	<u>1,400,000</u>	<u>-</u>	<u>3,485,113</u>	<u>4,180,267</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Digit-alb	23,100,000	7,316,400	30,526,380	569,000
	<u>23,100,000</u>	<u>7,316,400</u>	<u>30,526,380</u>	<u>569,000</u>

28. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

Shoqëria "Shqip" Shpk ka një kontratë qeraje e cila është lidhur me 01/03/2014 me afat të pacaktuar .

29. Ngjarje pas bilancit

Para përfundimit të pasqyrave drejtimi I shoqërisë është njoftuar nga bordi I aksionereve se shoqëria do të ketë ristrukturim si pasojë e humbjeve që ka pësuar vitet e fundit.